



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 447/10 prot.,

Datë 09.03.2026

V E N D I M
Nr. 367/2026

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.03.2026 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 288/2026, datë 20.02.2026 në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojat të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit 3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “Bajro Bros” SHPK me Nipt M113130290 dhe adresë: Rruga “Ndre Mjeda”, Kompleksi rezidencial “Magnet” Pallati Lura, njësi shërbimi nr.1017, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Ujësjetllës Kanalizime Tiranë sh.a
Rruga e Kavajës, Ndërtesa nr.133, Njësia Administrative 6, Kodi Postar 1027, Tiranë

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “2AK Group” SHPK me Nipt. M42626404R dhe adresë: Rruga “Kastriot Muco”,Lagja “8 shkurti”, Nd 66, Fier.

Operatori ekonomik “KEJ Group” SHPK me Nipt. M41707006H dhe adresë: Rruga “Sami Frasheri”, Pallatet “Agimi”, Shkalla 22, Ap. 370, Tiranë

Operatori ekonomik Eduart Xhixha me Nipt. L54424205B dhe adresë: Ndertese private, 2 kateshe,kati pare mbi toke, zona kadastrale nr.3096, me numer pasurie 97/32/1 Nickel, QEREKE Durrës

Operatori ekonomik “IGLI-SAND” SHPK me Nipt. J94625209A dhe adresë:,Rruga Kryesore, ndertese private 1 kateshe,zona kadastrale 3096, me nr.pasurie 88/32, Fshati Qereke, Nickel, QEREKE, Durrës

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në datë 20.02.2026, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 288/2026, ku vendosi:

[.....]

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Bajro Bros” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojë të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit 3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a.
2. Autoriteti Kontraktor të rivlerësojë ofertën e operatorit ekonomik “2AK Group” SHPK sipas konstatimeve të këtij vendimi.
3. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Bajro Bros” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publikk.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë” [...]

I.2. Me shkresën nr. 3527/1 prot., datë 02.03.2026, protokolluar me tonën nr. 447/7prot., datë 05.03.2026, autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 288/2026 datë 20.02.2026.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton

II.1. Me shkresën nr. 3527/1 prot., datë 02.03.2026, protokolluar me tonën nr. 447/7prot., datë 05.03.2026, autoriteti kontraktor Ujësjiellës Kanalizime Tiranë sh.a, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 288/2026 datë 20.02.2026.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se autoriteti kontraktor ka kryer rivlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik në përputhje me vendimin e KPP Nr. 288/2026, datë 20.02.2026

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar- Mallra”, me REF--73591-12-31-2025, me objekt: “Blerje materiale për zyra për nevojë të shoqërisë UKT sh.a.”, me fond limit

3.397.000 (tre milion e treqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë) lekë pa TVSH zhvilluar më datë 16.01.2026 nga autoriteti kontraktor, Ujësjellës Kanalizime Tiranë sh.a..

2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

